Nisur nga sa më lart, KVO gjykon dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është i plotë dhe në përputhje me kriterin e kualifikimit pasi nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale për 1 punonjës specialist montim tubash.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me stafin teknik.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës..

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbyshjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 12 në DST shprehimisht parashikohet se... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **5.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Pepa Group sh.p.k me vlerë 17.829.281,93 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e tre).**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

#### **Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:**

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **10.547.952,65 (dhjetë milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH,** të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

**b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratë
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontrate;
  3. Leje ndertimi/shfrytëzimi per kryerjen e punimeve
  4. Situacionin përfundimtar;
  5. Akt kolaudimi objekti;
  6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Pepa Group” shpk për të përmbushur kriterin e mësipërm rezultoi se është ngarkuar në platformën elektronike Kontratë Nënkontraktimi midis shoqërisë Junik shpk dhe shoqërisë Pepa Group shpk (nën cilësinë e nënkontraktorit) , kontrata me objekt “Ndërtim rrjetit të shpërndarjes së ujit të pishëm dhe restaurimit të depove ekzistuese në Bashkinë Fushë-Arrëz, me vlerë nënkontraktimi 57.358.870 (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i Formularit të Vlerësimit rezultoi se vlera e kontratës së mësipërme të lidhur nëpërmjet AK, Bashkia Fushë-Arrëz dhe shoqërisë Junik shpk është 61.742.594 ( gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH , gjithashtu në formularin e vlerësimit të ngarkuar në sistemin elektronik të app-së citohet se: sipërmarrësi “Junik” shpk 100% të vlerës së kontratës me Investitorin dhe Nënkontraktori “Pepa Group” shpk 100% të vlerës së kontratës me sipërmarrësin

Nga sa më sipër kontrata e Nënkontraktimit midis dy shoqërive Junik shpk dhe Pepa Group është lidhur në kundërshtimin me ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nëni 61 pika 2 ku citohet se Përqindja e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjestim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së përgjithshme të kontratës, si dhe në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nëni 75 pika 3 ku citohet se “ Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.

Sqarojmë se vlera e përgjithshme e kontratës ka qenë 61.742.594 ( gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH , duke përllogaritur 40% të vlerës së kontratës e cila është vlera maksimale lejuar në rastin e nënkontraktimit rezultoi se vlera e nënkontraktimit nuk do të ishte më tepër se 24.697.037,6( njëzetë e katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e shtatë presje gjashtë ) lekë pa TVSH , ndërkohë që kontrata e nënkontraktimit e lidhur midis dy shoqërive mban një vlerë që tejkalon shprehur në

përqindje , vlerën e parashikuar në bazën ligjore dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij.

KVO , sa më sipër e konsideron kontratën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Pepa Group” shpk si kontratë të ngjashme , të lidhur në kundërshtim me nenet e parashikuara në bazën ligjore.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi profesionale të leshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 2 (dy) saldator
- 1 (nje) Specialist montim tubash

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

1.I.P shoqëruar me kontratë pune datë 25.01.2016(hidraulik) si dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

2.L.P shoqëruar me kontratë pune datë 25.01.2016 (hidraulik) si dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

3.L.B shoqëruar me kontratë pune (saldator) 08.12.2015 si dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

4.I.P shoqëruar me kontratë pune (saldator) 17.02.2017 si dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

5.B.P shoqëruar me kontratë pune (specialist montim tubash ) 08.12.2015 si dhe dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të

mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike ,pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Pepa Group sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST

**6.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Liqeni VII sh.p.k me vlerë 19.575.182 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

*cc)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontraten*

*perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

- dd) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
  - ee) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
  - ff) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
  - gg) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
  - hh) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
  - ii) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 23.10.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*
- Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha*

Operatori ekonomik "Liqeni VII" sh.p.k në shtojcën 10 (mbi disponimin e makinerive) ka deklaruar se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa DR0714F me kapacitet mbajtës I cili del nga leja e qarkullimit 17,2 ton.
- Kamion me targa AA015GN me kapacitet mbajtës I cili del nga leja e qarkullimit 15,76 ton mjet I cili do të konsiderohet I rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve min 12-17 ton.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 2 mjeteve kamion me kapacitet mbajtës **min 12 ton dhe max 17 ton pasi nga 2 mjete të kërkuara ka paraqitur të saktë vetëm 1 mjet sipas kapacitetit të kërkuar nga AK në DST.**

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operator

ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me mjetet me kapacitet mjetet me kapacitet min 12 ton-17 ton. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....* Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

### **Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:**

7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 7 (pese) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 2 (dy) punonjës
- Grupi II- (dy) punonjës
- Grupi III- 1 (nje) punonjës
- **Grupi IV- dy (dy) punonjës**

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST përkatësisht Grupi IV operatori ekonomik ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

1.Z.A. Mema shoqëruar me kontratë pune dhe me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik grupi IV.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin me emërtim” Grupi V në përmbushje të kriterit të grupit të IV”për punonjësën z.B.Gishti shoqëruar me kontratë pune,librezë pune,diplomë,liçensë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik me qëllim vërtetimin se z.B.Gishti disponon kategorinë V. Përsa cituam më lart operatori ekonomik nuk plotëson numrin e kërkuar në DST çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 7, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Në shtojcën 12 në DST shprehimisht parashikohet se....Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Pra sa më sipër Shoqëria “ **Liqeni VII** ” sh.a nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket ***personelit të nevojshëm*** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në*



procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 12 në DST shprehimisht parashikohet se...Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**7.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Kacdedja sh.p.k me vlerë 20.034.210(njëzet milion e tridhjetë e katër mijë e dyqind e dhjetë) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera

Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

**jj)** Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

**kk)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

**ll)** Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

**mm)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

**nn)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

**oo)** Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

**pp)** (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 23.10.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitohet në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

*Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha*

Operatori ekonomik “Kacdedja ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

1.Kamion me targa AA761BC e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 3,54 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 16.07.2019.

2. Kamion me targa TR8514G e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 3,54 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.

3. Kamion me targa TR7967S e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 3,49 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet e mësipërme operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësi vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 3 mjeteve kamion me kapacitet mbajtës **min 3,5 dhe max 5 ton pasi nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë sipas dokumentacionit të kërkuar në DST.**

Operatori ekonomik “Kacdedja ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

1.Kamion me targa AA263FK e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 25 ton .

2.Kamion me targa TR5106R e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 19.4 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 26.04.2018

3.Kamion me targa AA876DC e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 16.2 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019

4.Kamion me targa AA962DC e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 17 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019

5.Kamion me targa AA386NJ e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 16.8 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 02.07.2019 për të cilën konstatohet se mungon çertifikata për transport mallrash.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA876DC, AA962DC operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 2 mjeteve kamion me kapacitet mbajtës **12-17 ton** pasi nga 2 mjete të kërkuara nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë sipas kapacitetit mbajtës të kërkuar si dhe dokumentacionit të kërkuar në DST nga AK.

Operatori ekonomik “Kacdedja ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

1.Kamioncina me targa AA479EU e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 0.47 ton .

2.Kamioncina me targa AA426CZ e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.63 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 02.07.2019

3.Kamioncina me targa AA435JD e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.37 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019

4.Kamioncina me targa AA603FT e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.65 ton mjet I siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 11.04.2019

5.Kamioncina me targa . TR1952T e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 0.96 ton .

6.Kamioncina me targa AA253OX e cila sipas lejes së qarkullimit rezulton të jetë me kapacitet mbajtes 1.05 ton .

7.Kamioncina me targa AA637OD për të cilën rezulton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion shoqërues në sistemin elektronik si leje qarkullimi,policë sigurimi,certifikatë kontrolli teknik etj çka bie në kundërshtim me kushtet e kërkuara në DST.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetet me targa AA426CZ, operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, ,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Ndërsa referuar mjetit me targa AA603FT mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 11.04.2019 rezulton se çertifikata për transport rezulton të jetë në emër të shoqërisë qeradhënëse dhe jo çertifikatë e lëshuar me të dhënat përkatëse për mjetin me targa AA603FT.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 3 mjeteve kamioncina me kapacitet mbajtes **1,5- 2 ton** pasi nga 3 mjete të kërkuara nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë sipas kapacitetit dhe dokumentacionit të kërkuar.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me mjetet me kapacitet 3,5 ton-5 ton ,mjetet me kapacitet 1,5-2

ton si dhe mjetet me kapacitet min 12 ton-17 ton sipas kapacitetit dhe dokumentacionit të kërkuar në DST.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kacdedja ”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....* Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **8.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Kurti 07 sh.p.k me vlerë 20.915.775(njëzet milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

*g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

“Në përmbushje të kriterit të kërkuar operatori ekonomik Kurti 07 sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik :

*“Vërtetim debie” nr. 11116/1 prot, date 24.05.2019 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së*

*Energjisë Elektrike në emër të kërkuarit “Kurti 07” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 23.05.2019 duke përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019.*

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debitit i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin shtator 2019.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

*Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 30.09.2019 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 06.11.2019 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit shtator 2019 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”*

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

**qq)** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

**rr)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

**ss)** Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

**tt)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

**uu)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

**vv)** Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te



*deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

*ww)*

*(op*

*sion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 23.10.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

*Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive” për objektin e prokurimit.

Nga verifikimi i makinerive të deklaruar në shtojcën 10 nga operatori ekonomik konstatohet se operatori ekonomik “Kurti 07” sh.p.k nuk ka deklaruar autobetoniere.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon dhe verifikon vetëm mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Theksojmë se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve (sipas listës së mjeteve të kërkuara nga AK) pasqyron të gjitha mjetet që operatori ka ndërmend të angazhojë për realizimin e objektit të prokurimit dhe këto mjete nuk janë të angazhuara në AK të tjera duke krijuar bindjen kështu AK se operatori ekonomik disponon mjetet për realizimin e kontratë objekt prokurimi.

Gjithashtu sqarojmë se edhe nëse operatori ekonomik Kurti 07 do të kishte paraqitur dokumentacion shoqërues në sistemin elektronik për mjetin autobetonere (mjet i padeklaruar në shtojcën 10) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk do ta merrte në shqyrtim për shkak se KVO kontrollon dhe verifikon vetëm mjetet të cilat operatori ekonomik i ka deklaruar në shtojcën 10.

Në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka deklaruar autobetoniere në shtojcën 10 tregon qartazi se operatori ekonomik Kurti 07 sh.p.k nuk e disponon dhe nuk zotëon këtë mjet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **9. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Llazo sh.p.k me vlerë 20.990.028(njëzet milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë pa tvsh .**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të

miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

*g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Në përmbushje të kriterit të kërkuar operatori ekonomik Llazo sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik :

*“Vërtetim debie” nr. 93 prot, date 17.07.2019 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në emër të kërkuesit “Llazo” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 17.07.2019 Pa përfshirë faturën koherente të muajit korrik 2019.*

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Shtator 2019.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

*Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 30.09.2019 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 06.11.2019 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit shtator 2019 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit*

*kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**10.Oferta e paraqitur nga BO”KMK sh.p.k&Caushi sh.p.k me vlerë 19,119,660(nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 14 si më poshtë cituar:

14..Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum	3 cope	Pronësi ose me qera

1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë		
Prerëse asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

**xx)** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

**yy)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

**zz)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

**aaa)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

**bbb)** *Ma kineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara ne procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

**ccc)** *(op sion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 23.10.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa*

*paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.  
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.*

Operatori Ekonomik "KMK" sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamioncinë me vinc me targa **AA179ID** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,2 ton.
- Kamioncinë me targa **FR 0456D** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,42 ton për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 30.10.2019.
- Kamioncinë me targa **AA136XO** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,1 ton.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton dhe max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamioncinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Operatori Ekonomik "KMK" sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa AA139CJ me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,27 ton.
- Kamion me targa AA794KK me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,49 ton për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 02.11.2019.
- Kamion me targa AA870EK me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,2 ton.

**Sa më sipër cituar operatorët ekonomikë nuk e përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 3,5 ton dhe max 5 ton ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin

konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionçinat me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton si dhe mjetet me kapacitet 3,5 ton -5 ton.

- Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga .BO”K.M.K&”Caushi”sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

## **2.Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:**

*f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik Caushi/M sh.p.k ka deklaruar se disponon mjetet dhe pajisjet teknike autobetoniere,matrapik,fadromë skrep për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Referuar natyrës së zërave të punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik Caushi/M sh.p.k në kontratën e bashkëpunimit nr.5042 rep ,1006 kol datë 05.11.2019 përkatëisht zërat me numër rendor nga 1 deri në zërin 14 të preventivit të punimeve operatori i sipërcituar duhet të dëshmonte se disponon mjetet kamion ,prerëse asfalti si dhe vibrator me dokumentacion shoqërues për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Theksojmë se në nenin 74 të VKM nr.914,datë 29.12.2014”Rregullat e Prokurimit Publik”i ndryshuar parashikohet se plotësimi i kriterëve teknike duhet të bëhet nga sejcili pjestar i BO në përputhje jo vetëm me % por edhe natyrën e punimeve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Së treti në kontratën e bashkëpunimit datë 05.11.2019 operatorët ekonomikë kanë bërë ndarjen në përqindje të punimeve e cila rezulton 21,75% nga operatori ekonomik Caushi/M sh.p.k dhe 78,25% nga operatori ekonomik K.M.K sh.p.k.

Referuar ndarjes së punimeve në kontratën e bashkëpunimit me zërat përkatës në preventivin e ofertës KVO vëren se ka mospërputhje të përqindjes së punimeve të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit me preventivin e ofertës së paraqitur.

Konkretisht duke iu referuar zërave të marrë përsipër nga operatori ekonomik Caushi/M sh.p.k në të

vërtetë përqindja e punimeve për operatorin e sipërcituar është 43,44%( 8,305,880 lekë pa tvsh)ndërsa për operatorin ekonomik K.M.K sh.p.k përqindja e punimeve është 56.56%(10,813,780 lekë pa tvsh).

Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Për këtë shkak ndarja e përqindjes për zërat konkretë duhet të jetë strikte, e mirpërcaktuar dhe në cdo rast të përputhet me atë masë përqindje që ka marrë përsipër të realizojë secili prej anëtarëve në kontratën e bashkëpunimit.

Bazuar në këtë mospërputhje, KVO gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisht (kontrata e bashkëpunimit dhe preventivi i paraqitur) nuk është hartuar sakte dhe në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 914 datë 29.12.2014“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe konsiderohet shkak për skualifikim.

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, **me dëshmi kualifikimi profesional** të lëshuar nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) hidraulik
- 2(një) saldator
- 1(një) specialist për montim tubash

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik vëren se në përmbushje të kriterit të sipërcituar për punonjës të specialist montim tubash ka paraqitur :

1.z. Kosta Elmazi (montator) paraqitur nga operatori ekonomik KMK sh.p.k shoqëruar me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001”Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se...Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:

a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të

mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj;

e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike ,pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë K.M.K sh.p.k &”Caushi” sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Theksojmë se në një procedurë prokurimi,subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

#### **11.Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik Colombo sh.p.k me vlerë 18.107 .289 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Më datë 12.11.2019 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik Colombo “sh.p.k me lëndë ”Deklaratë tërheqje” prot hyrës 26368, datë 12.11.2019 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura objekt prokurimi.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “**Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.**” Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomikIina shpk.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër KVO vendos **të skualifikojë** operatorin ekonomik “Colombo”sh.p.k.

#### **12.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Al Asphalt sh.p.k me vlerë 17.976.107(shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatë) lekë pa tvsh.**

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978,[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al).



Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik “Al Asfalt ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

14..Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

**ddd)** Për  
*mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

**eee)** Për  
*mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

**fff)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

**ggg)** Aut  
*oriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

**hhh)** Ma  
*kineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

**iii)** *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 23.10.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër; dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitohet në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*

*Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.*

- Kamion me targa AA246UF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,7 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.
- Kamion me targa KO3201B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,5 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.
- Kamion me targa AA452EA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,5 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA246UF, KO3201B, AA452EA operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, çertifkatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe certifikatë për transport mallrash për

llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 3 mjeteve kamionave me kapacitet mbajtës **3,5 - 5 ton** pasi nga 3 mjete të kërkuara nuk ka paraqitur asnjë mjet të saktë sipas dokumentacionit të kërkuar në DST.

Operatori ekonomik “Al Asfalt ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamionçinë me targa AA829GR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,8 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.
- Kamionçinë me targa AA879RY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2 ton i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klaifikohet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-2 ton.
- Kamionçinë me targa AA855BY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,5 ton i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klaifikohet në kategorinë e mjeteve min 1,5 ton-2 ton.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA829GR operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, çertifikatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

Paraqitjen e 3 mjeteve kamionçina me kapacitet mbajtës **1,5 - 2 ton** pasi nga 3 mjete të kërkuara ka paraqitur të saktë vetëm 2 mjete.

Operatori ekonomik “Al Asfalt ” sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa AA873II me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 14,3 ton i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klaifikohet në kategorinë e mjeteve min 12 ton-17 ton.
- Kamion me targa AA085PG me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 12,9 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019.
- Kamion me targa KO6015B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 13 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës së qerasë datë 05.11.2019

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për mjetin me targa AA085PG,KO6015B operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, çerifikatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata e lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

**Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:**

- Paraqitjen e 2 mjeteve kamion me kapacitet mbajtës **12 ton - 17 ton** pasi nga 2 mjete të kërkuara ka paraqitur të saktë vetëm 1 mjet sipas dokumentacionit të kërkuar në DST.
- Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin

kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 14 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, në lidhje me kamionçinat me kapacitet mbajtës min 1,5 ton dhe max 2 ton mjetet me kapacitet 3,5 ton - 5 ton si dhe me mjetet min 12 ton-17 ton.

- Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Al-Asfalt sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*
- Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Theksojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit AK ka kërkuar si më poshtë vijon:

### 3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik KVO vëren se në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik “Al –Asfalt sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim për taksat vendore lëshuar nga Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Shijak, Bashkia Kavajë, Bashkia Durrës nr.prot 69, datë 18.03.2019.

Referuar ekstraktit historik të operatorit ekonomik konstatohet se shoqëria më datë 04.09.2019 ka hapur adresë dytësore pranë Bashkive Korçë, Bulqizë, Velipojë për të cilën evidentohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore sipas adresave të regjistruar në QKR.

Mbështetur në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006”Për sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar neni 14 citohet se... Taksa paguhet në katër këste të barabarta.

Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

Përfundimisht KVO gjykon se operatori ekonomik duhet të paraqiste vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për bashkitë Korçë, Bulqizë, Velipojë sipas afateve të përcaktuara në dispozitat

ligjore **përkatësisht këstit të tretë i cili i përket datës jo më vonë se 20 tetor.**

Përsa i përket vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Durrës nr.prot 69,datë 18.03.2019 vërehet se në përmbajtje shprehimisht citohet se...**ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë Durrës deri në datën e marrjes së vërtetimit.** Pra nga përmbajtja e dokumentacionit të mësipërm lehtësisht vërtetohet se operatori ekonomik **ka shlyer detyrimet deri më datë 18.03.2019.**

Mbështetur në ligjin nr.9632,datë 30.10.2006”Për sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar neni 14 citohet se... **Taksa paguhet në katër këste të barabarta.**

**Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.**

Mbështetur në nenin 14 të ligjit nr.9632,datë 30.10.2006”Për sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar operatori ekonomik duhet të kishte dëshmuar se ka paguar këstin e dytë dhe të tretë për Bashkinë Durrës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik” Viante Konstruksion” shpk me NIPT K47103804L, me administrator Z. Gjergji Bezati, me seli në Adresën: Elbasan, Gramsh, SPORTI, me vlerë të ofertës: 19.514.216(nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e katërmëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.11.2019

**Ankesa:** Nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**REDI MOLLA**

